

Patriku Neofit - 8 vjet në krye të Kishës Ortodokse Bullgare



Kisha Ortodokse Bullgare shënon sot tetë vjet nga zgjedhja dhe ulja në fron e Shenjtërisë së Tij Neofit si Patriark Bullgar dhe Metropolit i Sofjes. Kjo u njoftua nga Mitropolia e Sofjes.

Me rastin e festës në katedralen e Mitropolisë “Martirja e Shenjë e Diela” u kremtua një liturgji e shenjtë.

Më 24 shkurt 2013 Këshilli Zgjedhor Patriarkal zgjodhi me 90 vota si Patriark i Kishës Ortodokse Bullgare Mitropolit Neofit i Ruse, i lindur me emrin laik Simeon Nikollov Dimitrov.

Ai u zgjodh pasi Patriarku Bullgar Maksim, kreu i fundit i Kishës Ortodokse Lindore të epokës komuniste, vdiq në fund të 2012 në moshën 98 vjeç.